

UNIVERSITETI I GJAKOVËS "FEHMI AGANI"

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DEGA: GJUHË SHQIPE



PUNIM DIPLOME

SHQYRTIM SEMANTIK I FJALËVE DHE FRAZELOGJIZMAVE NË
DEÇAN DHE RRETHINË

MENTORI:

Prof. ass. dr. Fridrik Dulaj

KANDIDATJA:

Ermerinda Zekaj

GJAKOVË, 2017

PËRMBAJTJA

Hyrje..... 4

Kreu I GJUHA DHE GJUHËSIA (1.1-1.9)

1.1. Gjuha, gjuhësia dhe zhvillimi i saj..... 5

1.2. Gjuha si sistem themelor i komunikimit dhe funksionet e saj..... 6

1.3. Gjuha standarde dhe dialektet..... 8

1.4. Leksikologjia si shkencë..... 9

1.5. Idetë dhe parimet e leksikologjisë shqipe..... 10

1.6. Detyrat e leksikologjisë dhe lidhjet e saj me shkencat e tjera..... 11

1.7. Fjalorët e gjuhës shqipe..... 12

1.8. Stilistika dhe objekti i studimit të saj..... 13

1.9. Semasiologjia..... 14

KREU II NJOHURI TË PËRGJITHSHME PËR FJALËN (2.1 -2.4)

2.1. Fjala dhe veçoritë e përgjithshme të saj..... 16

2.2. Vlerat e fjalëve..... 17

2.3. Kuptimi si anë e fjalës..... 18

2.4. Ngjyrimet stilistike..... 19

KREU III KUPTIMI SI ANË E FJALËS (3.1)

3.1. Fusha kuptimore e fjalës (Shembuj dhe shpjegime)..... 20

KREU IV NJËSITË FRAZEOLGJIKE (4.1-4.3)

4.1. Njësitë frazeologjike..... 23

4.2. Klasifikimi i njësive frazeologjike..... 25

4.3. Shembuj dhe shpjegime..... 28

Përfundimi..... 29

Literatura..... 30

Abstrakt

Duke qenë se fjala ka dy anë, që janë të pandashme, ajo menjëherë zgjon kureshtjen për ta studiuar rrënjësisht, duke harruar përkufizimin teorik të saj.

Në këtë punim vërehet se fokusi nuk është në formën e fjalëve, ndërtimin a funksionin që kanë në fjali, por në kuptimet që kanë fjalët, vlerat emocionale e ngjyrimet, që krijohen sidomos nga lidhja e fjalëve me njëra-tjetrën.

Shembujt mbi të gjitha janë pasqyrim i kulturës shpirtërore, kohës e rrethanave, ku në mjaft raste e dëshmojnë evolucionin e gjuhës, pasi shumë prej tyre përdoren vetëm nga të moshuarit, sepse te të rinjët kanë kaluar në shtresën e leksikut pasiv.

Shembujt përveç që janë marrë nga zona e Deçanit, kryesisht nga folësit e fshatrave: Lëbushë, Isniq e Strelc, ata janë krahasuar me shembuj nga të folmet e tjera, të dhëna, që janë siguruar në librat e Destan Bajraktarit, Mehmet Gjevorit, Halil Kajtazit e nëpër fjalorë shpjegues të shqipes, të cilët dëshmojnë për një kulturë të përbashkët. Ndryshimet vërehen pothuajse vetëm në anën fonetike dhe shumë pak në anën morfologjike ose sintaksore (p.sh. topika).

Themeli i punimit u krijua nga lidhja e fjalëve, duke formuar njësi të pandashme, flasim pra për njësitë frazeologjike.

Fjalët kyçe: fjalë, njësi frazeologjike, kuptim, ngjyrimet emocionale, pasuri leksikore.

Hyrje

Gjuhësia, shkenca e cila e studion gjuhën, ndahet në nëndisiplina, por puna në këtë punim gjeti më shumë mbështetje nga leksikologjia, semantika e stilistika, pasi ato japin të dhëna për anën e fjalës, e cila na intereson në këtë rast: kuptimi.

Do të përshkruhet rruga e gjuhësisë, pse vlerësohet gjuha si një nga sistemet themelore të jetës njerëzore, a kryen vetëm një funksion, apo shtrihet në shumë rrafshe.

Puna kryesore është të sqarohet si është e mundur që një fjalë të shpreh shumë kuptime dhe në anën tjetër i njëjti kuptim të shprehet nga ndërtime të ndryshme. Pse e njëjta fjalë shpreh kuptime të ndryshme kur lidhet me fjalë të tjera e lidhjet me fjalë të ndryshme japin kuptime afërisht të ngjashme, ku asnjë fjalë nuk është e njëjtë.

Do të shpjegohen karakteristikat e fjalës, si krijohen njësitë frazeologjike (cilat janë kushtet për formimin e tyre, ndarja e tyre mbi çfarë kriteresh bazohet dhe çka dëshmon pasuria frazeologjike për një popull?).

Metodat e përdorura janë ajo deduktive dhe induktive, në përfundim edhe metoda krahasuese, për të parë se a ka dallime në fushën kuptimore të fjalës në të folme të ndryshme.

Kreu I

Gjuha dhe gjuhësia

1.1. Gjuha, gjuhësia dhe zhvillimi i saj

Dija njerëzore përbëhet nga shkencat e natyrës dhe nga shkencat shoqërore, në këto të fundit përfshihet edhe gjuhësia, që studion gjuhën.

Gjuha studiohet për arsye teorike dhe praktike njëkohësisht. Duke qenë shfaqja më konkrete e jetës njerëzore, ajo mbetet hallka për ta kuptuar vetë shoqërinë njerëzore dhe e dallon atë nga shoqëritë e tjera.

Në përgjithësi shkenca e gjuhësisë kaloi nëpër tri faza dhe u karakterizua me emërtime të ndryshme. Në fillim "gramatikë", studim i mbështetur në logjikën, dallonte format e drejta nga të padrejtat. Ishte themeluar nga grekët dhe francezët, por ishte larg nga një vrojtim i veçantë gjuhësor. Më vonë filologjia (gr. e vj.: filo-mik dhe logos- "gjuhë", dije), që si metodë të saj përdorte kritikën, si shkollë ekzistonte që në Aleksandri. Periudha e tretë ishte gramatika krahasuese dhe sot për termin gjuhësi po përdoret termi linguistikë (lat. : lingua- gjuhë).

Deri në shekullin e XIX gjuhësia nuk ishte disiplinë në vete, por ishte pjesë e filozofisë edhe pas ndarjes, në fillim, ajo shihej si shkencë biologjike e më vonë si pjesë e psikologjisë. Pas një kohe jo shumë të gjatë gjuhëtarë të shquar e vendosen gjuhësinë në vendin e merituar, por duke e pasur parasysh mos izolimin si shkencë, kështu ajo përfundoi si një nga shkencat më të përparuara, ishte model metodologjik, që shquhej për karakterin sistemor dhe rolin në shoqëri.

Për gjuhën kanë dhënë përkufizime gjuhëtarë të shumtë. Objekt i studimit gjuhësor mund të jetë gjuha e folur ose gjuha e shkruar, por mund të studiohen edhe dukuritë e tjera jashtëgjuhësore.

Gjuhësia përjetoi një përmbyse nga ideologjia e gjuhëtarit Ferdinand De Saussure (strukturalist), i cili konsiderohet themelues i gjuhësisë moderne. Sipas Sosyrit gjuhësia merret me studimin e gjuhës "më vete dhe për vete".

Gjuha sipas Sosyrit "nuk nënkuptohet si ligjërim, ajo është vetëm një pjesë e caktuar e tij¹.

¹ Ferdinand De Saussure, *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*, Dituria, Tiranë, 2002, f. 17-18.

"Derisa ligjërimi është heterogjen, gjuha e përkufizuar kështu ka natyrë homogjene; është një sistem shenjash ku thelbësor është vetëm bashkimi i kuptimit me përfytyrimin tingullor dhe ku të dyja pjesët e shenjës janë njësoj psikike"².

Gjuha nuk ndërtohet nga paramendimet, individi e regjistron atë pasivisht, kurse të folurit lidhet me vullnetin dhe inteligjencën.

Sipas Sosyrit gjuha është një nomenklaturë (listë termash, që u përgjigjet po aq gjërave), kurse shenja gjuhësore bashkon një koncept me një përfytyrim tingullor. Ishte Sosyri ai që krijoi kundërvëniet: gjuhë/të folur, sinkroni/diakroni dhe shenjues/i shenjuar.

Një kontribut të shquar dha edhe Andrea Martine, i cili shtroj kërkesën që në studimet gjuhësore të ketë më shumë realizëm e më pak formalizëm.

"Tash mund të provojmë të formulojmë çka kuptojmë me gjuhë" . Gjuha është mjet marrëveshjeje simbas të cilit përimitohet përvoja njerëzore, ndryshe në çdo bashkësi, në njësi të përmbushura me një përmbajtje semantike dhe me një shprehje tingullore, monema; kjo shprehje tingullore, nga ana tjetër, nyjëtohet në njësi dalluese dhe të njëpasnjëshme, fonema, të përcaktuara në numër në çdo gjuhë, natyra dhe raportet midis të cilave gjithashtu dallojnë nga gjuha në gjuhë"³. Kështu e përkufizon A. Martine gjuhën.

Gjuha mund të studiohet në aspektin sinkronik dhe diakronik. Kur bëjmë studim sinkronik fokusohemi në një pikë kohore të caktuar, ndërsa diakronik quhet çdo studim, që nxjerr përfundime pas krahasimeve të përdorimeve të ndryshme të së njëjtës gjuhë. Diakronia kështu mbështetet jo vetëm në të tashmen, por edhe në të kalurën. Kjo na lejon krijimin e dy boshteve: boshtin horizontal, që është boshti i sinkronisë (gr. e vj. syn- bashkë dhe kronos-kohë, me kuptimin e përgjithshëm bashkëkohësi) dhe boshti vertikal ose i diakronisë (gr. e vj. dia- përmes dhe kronos-kohë). "Po të ndjekim rrugën e parë, çdo fakt i gjuhës do të shihet si element i sistemit, i lidhur ngushtë me elementet e tjera që bashkekzistojnë me të, ndërsa, po të ndiqet rruga e dytë, çdo fakt gjuhësor do të merret në lidhje me faktet që i paraprijnë ose që e ndjekin historikisht"⁴.

²Ferdinand De Saussure, *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*, Dituria, Tiranë, 2002, f. 42.

³ Andrea Martine, *Elemente të gjuhësisë së përgjithshme*, Rilindja, Prishtinë, 1974, f. 47.

⁴ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, Tiranë, 2004, f. 56.

1.2. Gjuha si sistem themelor i komunikimit dhe funksionet e saj

Asnjë veprimtari njerëzore nuk mund të mendohet pa shkëmbimin e mesazheve, pra të komunikosh do të thotë të jetosh. Komunikimin mund ta realizojmë me anë të sistemeve të shenjave, që kanë të përbashkët mekanizmin komunikues dhe çdo akt komunikimi, sado i thjeshtë që duket, përbën dukuri të ndërlikuar.

Këto sisteme ndahen në tri grupe : sistemet e shenjave që mund ta zëvendësojnë plotësisht gjuhën (alfabeti mors, braj, sisteme fishkëllimash ose daullesh të disa fise), sistemet që e shoqërojnë të folurit, mbështeten të gjuha, por nuk e zëvendësojnë atë dhe në grupin e tretë kemi gjuhët speciale, të cilat përdoren nga logjicentët dhe inxhinierët e programimit.

Duke qenë se gjuha na mundëson shkëmbimin e mesazheve, kjo nuk do të thotë se një mesazh ka vetëm një funksion gjuhësor. Natyra e mesazhit përcaktohet nga funksioni mbizotërues ndër funksionet e ndryshme. Gjuha ka funksion njohës, ekspresiv, fatik, konativ etj. .

Funksioni njohës quhet ndryshe edhe referencial dhe lidhet me referentin a kontekstin e komunikimit. Funksion njohës kemi atëherë kur thënia na ofron informacion të ri për botën. Informacioni i tillë jepet në mënyrën dëftore, në formë pohimi (mund të jetë i vërtetë ose i rremë).

Kur folësi me anë të asaj që kumton i shpreh ndjenjat, kemi funksionin ekspresiv, shprehës a emotiv (zakonisht përdoren pasthirrmat, pasi japin ngjyrimë).

“Gjuha përdoret në funksionin fatik (gr. vj. phatos “i folur”) atëherë kur me anë të saj synohet të vendoset kontakti midis folësit dhe dëgjuesit ose të verifikohet nëse kanali i komunikimit funksionon”⁵.

Kur gjuha ka funksion konativ folësi nxit dëgjuesin të bëjë diçka, përdor fjalitë urdhërore ose thirrmore. Kur theksi vihet mbi mesazhin, kemi funksionin poetik. Funksioni performativ ka të bëjë me realizimin e përmbajtjes së një mesazhi verbal. “Sa herë që folësi ose dëgjuesi duan ta verifikojnë nëse janë duke përdorur të njëjtin kod, kemi të bëjmë me funksionin metagjuhësor (metalinguistik) të gjuhës”⁶.

⁵ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, Tiranë, 2004, f. 25.

⁶ Po aty, f.28.

1.3. Gjuha standarde dhe dialektet

Gjuhësia si shkencë në fillimet e saj është marr me krahasimin e gjuhëve, duke zbuluar kështu lidhjet e tyre. Studiuesit afërsinë e gjuhëve e përcaktonin nga krahasimi i përbërjes fonemore të fjalëve, mbaresave dhe kuptimeve.

Gjuhët ndahen sipas klasifikimit gjenealogjik në familje, pastaj në degë dhe në nëndegë.

Një nga familjet gjuhësore është edhe indoevropianishtja, në të cilën bën pjesë edhe gjuha shqipe. “Kjo familje ka një shtrirje të gjërë, nga gadishulli i Industanit në lindje e deri në gadishullin Iberik në përqendrim dhe nga gadishulli Skandinav në veri në gadishullin e Ballkanit në jug”⁷.

Gjuha e një bashkësie ka variantet të organizuara në mënyrë hierarkike. Shtresën e parë e përbëjnë ligjërimet individuale, pastaj kemi të folmet vendore, të folmet krahinore, nëndialektet dhe dialektet. Kreu i kësaj piramide është gjuha standarde.

“Në çdo vend gjuha paraqitet me degëzime sipas krahinave, në mënyrë që, edhe pse e kuptojnë njeri-tjetrin, folësit e njërës krahinë dallohen nga ata të një tjetre”⁸.

Gjuha shqipe ka dy dialekte (gr. dialectos-bisedë, kuvendim, diskutim), që i përgjigjen ndarjes së etnikumit shqiptar: toskërishten (pjesa jugore) dhe gegërishten (pjesa veriore).

Gjuha duke qenë shenjë dalluese e kombit dhe mjet për arritjen e unitetit kombëtar, ka për detyrë ta lehtësojë komunikimin e popullit, në pjesë të ndryshme të vendit. Për këtë arsye formohen gjuhët standarde, si variante të kodifikuara. Veçori e gjuhës standarde është përdorimi i detyrueshëm i trajtave normative nga të gjithë folësit.

Zakonisht, si gjuhë standarde pranohet ajo gjuhë ose ai dialekt që ka numër më të madh folësish dhe ka prestigj më të lartë. Dialekti bazë i nënshtrohet një përpunimi, pjesë të tij bëhen edhe elemente nga dialektet e tjera. P.sh. gjuha standarde shqipe ka për bazë toskërishten, por asaj nuk i mungojnë elementet e dialektit gegë.

⁷ Rami Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, Tiranë, 2004, f. 295.

⁸ Prof.dr. Jorgji Gjinari dhe prof. dr. Gjovalin Shkurtaj, *Dialektologjia*, Perlat Voshtina, Tiranë, 2003, f. 37.

1.4. Leksikologjia si shkencë

“Leksikologjia është shkencë gjuhësore, që studion fjalët si njësi leksikore dhe leksikun, d.m.th. tërësinë e fjalëve, nga ndërtimi, nga kuptimi, nga shtresimi i mundshëm etj”⁹.

Në librat e kësaj fushe, është synuar të paraqitet zhvillimi i gjuhësisë shqiptare, arritjet e saj, sidomos deri në dhjetëvjeçarin e parë të shek. XXI dhe zhvillimet e fundit, pastaj të vendoset një simetri në mes të degëve të kësaj fushe. Kështu më në imtësi janë studiuar tema si: formimi i fjalëve, frazeologjia, norma gjuhësore, leksikografia etj. . Tekstet e kësaj natyre i gërshetojnë njohuritë teorike, historike dhe praktike.

Leksikologjia shqipe mori trajtat e një shkence në shekullin e XX.

“Në periudhën para viteve ’40 të atij shekulli janë bërë hapa me rëndësi në kërkimet leksikologjike, sidomos për të nxjerrë në dritë pasurinë leksikore e frazeologjike të shqipes, për ta pastruar atë nga lënda e huaj dhe për ta pasuruar me njësi e krijime prej brumit të vet”¹⁰.

Në periudhën e Rilindjes përveç pavarësisë së popullit, me ngulm punohej që shqipja të pastrohej nga fjalët e huaja, kështu u arritën përgjithësime dhe shënime për fjalët e shqipes. Mbetet edhe sot për t’u admiruar kontributi i lëvruesve të leksikologjisë shqipe: Sami Frashëri, Konstandin Kristoforidhi, Aleksandër Xhuvani e shumë të tjerë, pastaj nga të huajt: Gustav Majeri, Norbert Jokli etj. . Megjithatë shekulli i kaluar përfundoi me një sërë zbrazëtish, kjo pasi studimet mbështeteshin kryesisht në nisma të veçanta, studimet kryheshin më shumë për krahasime dhe në dobi të gjuhëve tjera sesa për të nxjerrë në dritë pasurinë e shqipes. Studimet shpesh nuk kishin bazë të shëndoshë teorike, zgjidhjet në plot raste ishin joshkencore dhe kryheshin nga dijetarë të shkollave të ndryshme.

Në vitet 1940-1960, institucionet shkencore përveç punës studimore, nisën vlerësimin e studimeve paraprake. Në vitin 1955 u themelua Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, në të cilin bënte pjesë një sektor i veçantë për leksikologjinë e leksikografinë, pastaj u përpunuan idetë dhe parimet teorike kryesore të leksikologjisë shqipe.

⁹ Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shipe*, Toena, Tiranë, 2006, f. 7.

¹⁰ Po aty, f.11.

1.5. Idetë dhe parimet e leksikologjisë shqipe

“Leksiku dhe frazeologjia shqipe vlerësohen si pasuri kulturore e përbashkët kombëtare, që duhet mbledhur e studiuar me synimin që të shërbejë për zhvillimin e gjithanshëm të shqipes standarde, për ta bërë këtë gjuhë sa më të fuqishme e më shprehëse”¹¹.

Leksiku ndahet në shtresa të caktuara, varësisht nga vlerat a dobitë, pavarësisht nga krijuesit ose krahinat.

Vendin kryesor në leksik e ka pasuria e krijuar nga populli. Fjalët dhe frazeologjitë popullore janë bërthama, gurra e pashtershme, që i shërben gjuhës letrare sa herë që ka nevojë.

Shtresa e leksikut në përgjithësi studiohet nga shumë anë, vlerësohen lidhjet ndërmjet njësisive, vlerat e prirjet e zhvillimit, forma dhe përmbajtja e shumë elemente të tjera.

“Fjala dhe leksiku filluan të shihen jo si njësi të vdekura, por si njësi që zhvillohen e ndryshojnë paprerë, që përsosen vazhdimisht, krahas zgjerimit e përsosjes së funksioneve shoqërore të gjuhës sonë standarde”¹².

“U mblodhën dhe u studiuan jo vetëm fjalë të rralla dhe shprehje të bukura, por edhe fjalë të njohura, frazeologji, kuptime të veçanta, lidhje fjalësh etj., për të dëshmuar kështu format, përdorimet, shtrirjen gjeografike dhe lidhjet e njësisive leksikore ndërmjet tyre”¹³. Një studim i thelluar iu bë edhe anës kuptimore të fjalës, rrugëve të lindjes së kuptimeve të reja dhe ngjyimeve stilistikore e emocionuese.

Edhe leksikologjia historike nuk kishte mbetur prapa, pasi ishin ndarë shtresat e huazimeve, arritje e rëndësishme ishte vlerësimi i shtresës indoevropiane, por megjithatë kërkohet një shpjegim historiko-etimologjik. Mbi të gjitha Eqrem Çabej i rikthej shqipes fjalët e veta, që mirreshin si huazime, kështu u krijua një pasqyrë e re etimologjike.

Në vitet 1970-1990 u pastrua leksiku i gjuhës standarde dhe u bë pasurimi nga brumi i shqipes, u formua “Komisioni i përhershëm për pastrimin e pasurimin e gjuhës letrare shqipe”. Deri në vitin 2005 u shënuan arritje në semasiologji, pak e lëvruar më parë dhe vlerat e funksionet stilistike tani shiheshin si pjesë e kulturës së gjuhës.

¹¹ Jani Thomaj, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Toena, Tiranë, 2006, f. 15.

¹² Po aty, f.16.

¹³ Po aty, f.16.

1.6. Detyrat e leksikologjisë dhe lidhjet e saj me shkencat e tjera

Sipas J. Thomait leksikologjia shqipe, që ka si objekt të vetin fjalën dhe leksikun e gjuhës sonë, ka përpara shumë detyra me karakter teorik e praktik. Të tilla detyra janë: studimi i fjalës dhe i kuptimit leksikor në gjuhën tonë, si edhe i lidhjes ndërmjet tyre, zbulimi i shkaqeve dhe i rrugëve të ndryshimit të kuptimeve të fjalëve; zbulimi i shkaqeve dhe i rrugëve të ndryshimit të kuptimeve të fjalëve; studimi i lidhjeve kuptimore ndërmjet fjalëve; studimi i tipave kryesorë të fjalëve sipas formimit; studimi i gjithanshëm i bashkimeve të qëndrueshme të fjalëve etj.¹⁴

Duke parë që leksikologjia i ka shtruar vetes detyra të shumta, ajo ka krijuar lidhje edhe me disiplina të tjera gjuhësore, si me: fonetikën, gramatikën e stilistikën, por edhe me shkencat jogjuhësore: historinë, psikologjinë e logjikën. Me disiplinat gjuhësore lidhet ngushtë pasi duke e pasur objekt studimi fjalën, kjo e fundit është e ndërtuar nga materia tingullore, pa tinguj nuk ka fjalë. Në anën tjetër fjalët ndahen në kategori gramatikore dhe lidhen në bazë të rregullave të caktuara, në mënyrë që ne t'i shprehim mendimet tona. Koha bën që një fjalë të paiset me kuptime të reja dhe pikërisht këtu arrihet lidhja e leksikologjisë me stilistikën.

¹⁴Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Toena, Tiranë, 2006, f.19-20.

1.7. Fjalorët e gjuhës shqipe

“Në fushën e hartimit të fjalorëve, d.m.th. të praktikës leksikografike, na ka ardhur një trashëgimi e mirë. Leksikografia është fusha më e hershme dhe më e pasur e gjuhësisë shqipe. Ajo fillon që në shekullin e XVII me “Fjalorin latinisht-shqip” të Frang Bardhit (“Dictinorium latino-epiroticum”, 1635) e deri më sot na ka sjellë mbi 500 fjalorë të shqipes, njëgjuhësh, dygjuhësh ose shumëgjuhësh, të cilët në pjesën shqipe regjistruan shumë fjalë e shprehje me vlerë, që i shpëtuan kështu humbjes”¹⁵.

Krahas fjalorëve të veçantë (krahinorë, sinonimesh, antonimesh, frazeologjikë etj.) shqipja ka edhe një numër të konsiderueshëm të fjalorëve dygjuhësh dhe fjalorë shumëgjuhësh (“Fjalori frazeologjik ballkanik”, në pesë gjuhë).

Vështrimi i leksikografisë u zgjerua me botimin e disa fjalorëve si: “Fjalor i gjuhës së sotme shqipe” (1980), “Fjalor i shqipes së sotme” (1984-2002), “Fjalor i gjuhës shqipe” (2006), “Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe” (1999) dhe “Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe” (2004).

Qysh në vitin 1972 parashiheshin detyrat e fjalorit shpjegues të shqipes, ai duhej të ndiqte dy drejtime: të ishte sa më normativ dhe informues e të hartohej në bazë të parimeve e kriterëve.

“Këto parime e kritere që rrjedhin pikërisht nga vetë qëllimet e detyrat kryesore të <<Fjalorit>> e që çojnë në plotësimin e tyre konkret, kanë të bëjnë, mbi të gjitha, me problemet e mëposhtme:

- I. Zgjedhja e fjalëve (përbërja e fjalësit).
- II. Frazeologjia dhe ilustrimet në fjalor.
- III. Struktura e fjalorit dhe struktura e artikullimit për çdo fjalë.
- IV. Homonimet .
- V. Zbërthimi e shpjegimi i kuptimeve të fjalëve.
- VI. Pasqyrimi i veçorive stilistikore të fjalëve.
- VII. Karakteristika gramatikore të fjalëve.
- VIII. Njohuritë etimologjike në fjalor.
- IX. Çështje të drejtshkrimit.
- X. Problemi i theksit”¹⁶.

¹⁵ Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Toena, Tiranë, 2006, f.12.

¹⁶ Grup autorësh (Universiteti Shtetëror i Tiranës), *Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhës shqipe*, Mihal Duri, Tiranë, 1972, f. 16.

1.8. Stilistika dhe objekti i studimit të saj

Gjuha nuk mjaftohet me shfrytëzimin e një sistemi të mjeteve, ku bëjnë pjesë tingujt, morfemat, fjalët e trajtat e caktuara, ajo krahas tyre përdor edhe rregulla për t'i vargëzuar këto njësi, por qëllimi kryesor i saj është të bëjë pasqyrimin e realitetit, të shprehë vijueshmëri logjike dhe t'u përshtatet synimeve të folësve, varësisht nga rrethanat e komunikimit.

Njerëzit zakonisht nuk shprehin mendime të dukshme, nuk koncentrohen vetëm në ofrimin e një informacioni mendor, sepse kështu përafrohen me robotët. Pra, ne kemi mundësinë të shmangemi nga sistemi gjuhësor i zakonshëm, të krijojmë një organizim të ri, duke përdorur mjetet e mundësitë shprehëse të shqipes dhe të formojmë të ashtuquajturin organizim dytësor.

“Gjuha është një dukuri e ndërlikuar dhe shumëplanëshe, prandaj ka një varg disiplinash që e studiojnë. Krahas niveleve të tjera të gjuhës dhe në lidhje me to ka edhe një nivel stilistik. Ky është objekti i stilistikës”¹⁷.

Gjuha ka funksion stilistik; stili është zgjedhje nga visari i gjuhës në përshtatje me qëllimet dhe natyrën e ligjëruesit (zgjedhje ndërmjet mënyrave sinonimike për ta shprehur po atë mendim, përmbajtje a kuptim). Stili është përdorim i shenjave gjuhësore, sillet një kuptim i ri, më kompleks e më i pasur nga shprehja e zakonshme.

Njësitë themelore të stilistikës janë stilemat, ato janë njësi të përbëra, kanë ngarkesa ose ngjyrimë, japin informacion plotësues krahas atij themelor, duke lënë të kuptohen lidhjet jashtëgjuhësore. Sa më të përbëra që janë, aq më të kufizuara janë në përdorim. Mënyra me të cilën ndërtohet stilema quhet përftesë.

Stilema ka tri mundësi shfaqjeje: me kufizim të plotë (stilema përdoret vetëm në një variant, tekst ose nga një autor); në kufizim të zakonshëm (shfaqet në një tip teksti, shumë pak në variante tjera) dhe me kufizim në përpjestime (përdoret më dendur në një variant sesa në variantet e tjera, p.sh. figurshmëria në letërsi e publicistikë).

Për ndërtimin e një stileme mund të marrin pjesë disa përftesa, ndër të cilat njëra është kryesorja. “Që një njësi e përbërë të qëndrojë më vete, pjesët e saj duhet të jenë të lidhura sipas

¹⁷ Xhevat Lloshi, Stilistika dhe pragmatika, Toena, Tiranë, 1999, f.7.

një parimi bashkues, i cili t' ngërthjë e të ketë diçka që ta dallojë nga lidhjet e domosdoshme të organizimit parësor”¹⁸.

Si përfundim përftesa krijon një strukturë karakteristike, që nuk është shumë e thjeshtë e gjymtyrëve, por krijon një vlerë të re.

1.9. Semasiologjia

Semasiologjia (nga gr. semasia “kuptim” ose domethënie dhe logos “dituri ose shkencë”) është pjesë e disiplinave gjuhësore, që studion anën kuptimore të njësisve gjuhësore. Si fushë studimi është e re, koha e lindjes së saj është shek. XIX.

Semasiologjia leksikore e shqipes është zhvilluar në dy rrugë: nëpërmjet hartimit të fjalorëve, sidomos të atyre shpjegues dhe në studimin për kategoritë e klasat e ndryshme leksikore.

Fjalorët tregojnë kronologjinë e ndryshimeve kuptimore, vëllimin, lëvizjet, ndarjen dhe renditjen e kuptimeve sipas prejardhjes. Ata na ndihmojnë t'i zbulojmë kuptimet, nuancat e nyjet semantike. “Le të marrim, p.sh., “Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe” : ai ka rreth 41.000 fjalë, rreth 7.000 njësi frazeologjike, por mbi 180. 000 kuptime (të fjalëve polisemantike), pra, numri i kuptimeve (si njësi themelore të semantikës) është thuajse katër herë e gjysmë më i madh sesa numri i fjalëve (si njësi themelore të leksikut)”¹⁹.

¹⁸ Xhevat Lloshi, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1988, f.28.

¹⁹ Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Toena, Tiranë, 2006, f. 75-76.

Kreu II

Njohuri të përgjithshme për fjalën

2.1. Fjala dhe veçoritë e përgjithshme të saj

Fjala është njësi leksiko-gramatikore. Ajo ka formën, e cila është fonetiko-gramatikore, pasi elementet fonetike i japin fjalës një kategorizim gramatikor dhe në anën tjetër ka përmbajtjen, e cila është leksiko-gramatikore, pra fjala shpreh një kuptim të caktuar, si në rrafshin leksikor, ashtu edhe në atë gramatikor.

Fjala ndërtohet nga njësi gjuhësore më të ulëta (tingujt e morfemat) dhe formon njësi të strukturave më të larta (togfjalësha e fjali).

“1. Një tipar themelor, pa të cilin një njësi nuk mund të quhet fjalë, është kuptimi leksikor tërësor dhe i mëvetësishëm. Fjala ka aftësinë të na japë diçka nga realiteti, të shënojë një realie (konkrete a abstrakte), të na lidhë me një send, me një dukuri, me një veprim a me një shfaqje tjetër çfarëdo”²⁰. Kështu duke u mbështetur në këtë fakt nyjat e përparme dhe pjesëzat trajtëformuese nuk kanë tipare të fjalëve. Rast mjaft interesant janë edhe onomatopetë, që kanë tipare të përbashkëta me fjalët, por edhe mjaft tipare dalluese.

Shpesh ndodh që trajtat e ndryshme të një fjale të konsiderohen si fjalë të ndryshme: *besoj, besova, kisha besuar...*

Fjalët e kanë trajtën e tyre përfaqësuese, që është mënyra se si paraqiten në fjalorë; për shembull, emrat duhet të jenë në rasën emërore, në numrin njëjës, trajta e pashquar, kurse foljet në mënyrën dëftore, koha e tashme, numri njëjës, veta e I.

Koha e shënon evolucionin e fjalëve, ato mund të pësojnë ndryshime në formë e përmbajtje. Fjala lind, ndryshon e zhvillohet, më në fund mund të vjetërsohet e të dalë nga përdorimi.. Zhvillimi i fjalëve lidhet në radhë të parë me historinë, pastaj me zhvillimin shoqëror, ekonomik e kulturor.

Fjalët mund të zhduken me konceptin që shënojnë, mund të zëvendësohen nga fjalë të tjera, që në një kohë të caktuar shihen si trajta më të sakta, dalin fjalët krejtësisht nga përdorimi, por edhe formohen fjalë të reja. Disa fjalëve u ndryshon përmbajtja, mund ta zgjerojnë fushën kuptimore dhe të rikuptimësohen, d.m.th. u zgjerohet fusha e përdorimit.

²⁰ Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Toena, Tiranë, 2006, f.36.

Pjesët e një fjale për t'i analizuar zakonisht i veçojmë, por në ligjërim ato janë pjesë të pandashme. Kur flasim ne nuk planifikojmë, pra nuk bëhet fjalë për përgatitje paraprake, procesi i të folurit është spontan, nuk shoqërohet nga pauza të gjata dhe luajnë rol të veçantë edhe faktorët jashtëgjuhësor, si: mjedisi, afërsia, përvoja e përbashkët etj. .

“Shqipja ka një visar të pasur fjalësh, kuptimesh, shprehjesh dhe mundësi të pakufijshme shprehëse”²¹. Zgjedhja e fjalëve shpreh mjeshtëri stilistikore. “ Fjala bëhet stilistikisht vepruese me bashkëveprimin e niveleve të ndryshme gjuhësore dhe me lidhjet jashtëgjuhësore. Marrëdhëniet gjuhësore të fjalës me fjalët e tjera mund të jenë: fonetike, grafike, morfologjike, fjalëformuese, sintaksore, leksikore, semantike. Marrëdhëniet jashtëgjuhësore, siç theksuam, kanë të bëjnë me ngjyrimet dhe me informacionin plotësues”²². p.sh. Ja fjala gur, si krijon marrëdhënie me fjalët e tjera, duke paraqitur anë të ndryshme të realitetit: *bone zemrën gur!; insoni ma i fort se guri; ata që t'gjun me gur, ti gjuje me bukë!; e gjun gurin e e mshef dorën.*

Fjalët zakonisht janë të lidhura me të tjerat e jo të veçuara. Lidhjet përcaktohen nga njohja e realitetit dhe kërkesat logjike. Lidhja e një fjale me të tjerat varet nga kuptimet leksiko-gramatikore të saj.

Secili nga ne jemi të lirë t'i përzgjedhim fjalët, me anë të së cilave do të shprehim qëndrimet, dëshirat, veçantitë etj. denduria e përdorimit të fjalëve është dëshmi e parapëlqimeve, fjalët që përdoren më shpesh janë edhe më të vjetra, me më shumë kuptime dhe më të shkurtra (foljet dhe mbiemrat kanë denduri më të qëndrueshme, foljet sepse lidhen më pak me rrethanat e jashtme, mbiemrat, sepse shprehin nocione të përgjithshme, kurse emrat kanë lëkundje sipas temës që trajtohet).

“Prania e ngjyimeve dhe mundësia e përdorimeve shprehëse i bëjnë fjalët e leksikut të shqipes të mos jenë njësoj, si me ngjyrë të përhime, por të kenë një spektër ngjyrash, me të cilat mund të vizatohen tablo të gjalla, sipas të gjitha kërkesave e dëshirave të ligjëruesit ²³. Emrin *dardhë* folësi ka mundësi të mos e përdor vetëm në kuptimin e parë (frut), p.sh. në rastet : *dardhë me bisht, dardha pikë nër dardhë*, por të marrë ngjyime kuptimore, varësisht nga kërkesat e folësit.

²¹ Xhevat Lloshi, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1988, f.117.

²² Po aty, f.92.

²³ Po aty, f.93.

2.2. Vlerat e fjalëve

Fjalët karakterizohen nga shumë vlera në ligjërim, aq sa nuk mund t'i japin as fjalorët më të mëdhenj shpjegues. Çështjet kryesore në këtë rast janë: cilat janë vlerat dhe si janë formuar, zhvillimi e pasurimi i tyre dhe në fund si sëndërtohen në stile të ndryshme.

Për t'i kuptuar vlerat e një fjale nuk duhet ta marrim të veçuar atë, ajo duhet parë në sa më shumë përdorime në gjuhën e gjallë. P.sh.

Nuk oshet' i hollë; oshet' mjeshter i hollë (i hollë në këto dy njësi frazeologjike ka kuptim krejt të ndryshëm, kjo është arsyeja pse duhet parë lidhjet e fjalëve, përdorimet e tyre, që kushtëzohen nga rrethanat e komunikimit; në rastin e parë kemi kuptimin: nuk është i menqur, kurse në rastin e dytë ka ngjyrim pozitiv, shprehet respekti për mjeshterinë e kryer si duhet).

Vlera më e madhe e fjalës është përmbajtja e saj, pra vlera semantike."Fjala lind e "jeton" në radhë të parë për kuptimet që ka dhe "vdes" kur s'ndihet nevoja për to"²⁴. Përmbajtja është më dinamike se sa forma, pasi ndryshon më shpejt.

Fjalët veçohen edhe nga vlerat emocionale, sidomos mbiemrat, pasthirrat e njësitë frazeologjike, që janë të mbuluara nga ana emocionale. Përdorimi i vlerës emocionuese të fjalës na dallon si në ligjërimin e shkruar, ashtu edhe në të folur. P.sh.

Qyqja unë! E bon rrenën nuse. E ka guhen shpatë.

Fjalët dallohen edhe nga vlerat stilistikore. Ngjyrimi stilistik lidhet me përmbajtjen leksikore në radhë të parë, por edhe me formën, ato kanë edhe aftësi fjalëformuese kjo mundësohet p.sh. nga prejardhja, kompozimi etj.

Fjalët kanë vlerë sintagmatike, pasi ato bashkohen në njësi më të larta dhe vlera paradigmatiske, ato grupohen në klasa e kategori sipas formës a kuptimit. Dhe në fund ato kanë aftësinë për ta zëvendësuar njëra-tjetrën, mund të njëjtësohen edhe me togfjalësha e perifriza: *Ka le me k'mishë* (ka lindur me fat); *s'kuqet hiq* (s'ka respekt fare për të tjerët) . Këta shembuj dëshmojnë për bashkimin e fjalëve dhe njëjtësimin e tyre.

Pra, fjala është njësi shumëvlerëshe, shfrytëzimi i këtyre vlerave e pasuron gjuhën, e bën më të fuqishme e më ndikuese.

²⁴ Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Toena, Tiranë, 2006, f.55.

2.3. Kuptimi si anë e fjalës

Sipas Xhevat Lloshit fjala është një grup tingullor, që ka trajtën sipas sistemit të gjuhës dhe që shënon në mënyrë të përgjithësuar diçka. Kuptimi i saj përcaktohet nga marrëdhënia me referimin e shenjuar, por edhe nga vendi në sistemin gjuhësor²⁵.

Synimi ynë kryesor është të formojmë fjalë, që kanë kuptime. Kuptimi ka natyrë komplekse, ai bart elemente të përfytyrimit, ngarkesa emocionale, shoqërime psikologjike e shoqërore. *Ma k'puti shpirtin* (mjafton ky ndërtim për të shprehur një gjendje të rënduar emocionale, një ndjenjë dhimbjeje të skajshme); *Ma shkrumoj shpirtin; ma plasi zemrën ..* e shumë shembuj të tjerë.

Fjala nuk duhet të merret si etiketë e dukurive, ajo nuk është identike me referimin, realiteti që shënon është shumë më i gjërë se sa ajo.

Duke i përfshirë fjalët në togje a fjali ne japim një kuptim, por harrojmë se fjala ka kuptime të shumta, që përcaktohen nga lidhjet e saj. P.sh. fjala *konop*, përveç kuptimit kryesor, shpreh edhe kuptime figurative: *Ai lyp konop t'lagtë; ai osh' si konopi n'thes* (në të dy rastet vërehet ngjyrimi negativ, 1. kërkon me u rrah mirë dhe 2. nuk është njeri i drejtë.

Varet nga folësi nëse zgjedh të japë kuptim të drejtpërdrejt, apo të figurshëm. Kuptimi i leksemave gjithmonë varet nga vendi dhe marrëdhëniet me fjalët e tjera (*Na humbe< je bo si biberi*, pra kombinojmë leksemat e ndryshme, por japim një kuptim.)

“Në qoftë se për çdo kuptim të ri do të krijohej edhe një gruptingull i ri, atëherë kujtesa e njeriut do të dërrmohej nën peshën e tyre të madhe, sepse është më lehtë të mbash mend një shenjë gjuhësore (gruptingull) me dhjetë kuptime (1 gruptingull + 10 kuptime =11 njësi) sesa të mbash mend dhjetë shenja gjuhësore të ndryshme (gruptinguj) me nga një kuptim (10 gruptinguj + 10 kuptime = 20 njësi) ”²⁶.

²⁵ Xhevat Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Toena, Tiranë, 1999, f.128.

²⁶ Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Toena, Tiranë, 2006, f. 75-76.

2.4. Ngjyrimet stilistike

Fjalët përgjatë shekujve kanë pësuar ndryshime shumë të vogla nga ana leksiko-gramatikore, por ato e kanë zgjeruar strukturën e kuptimeve. Kështu kuptimet leksikore nga ato gramatikore i dallon aftësia e zhvillimit dhe e ndryshimit.

Struktura kuptimore e fjalës ka vlera të mëdha, jo vetëm në numrin e kuptimeve, por edhe nga lloji. Kuptimi mund të jetë i drejtëpërdrejtë (konkret) i prejardhur (abstrakt) dhe i figurshëm, që karakterizohet me ngjyresa të holla (stilistik).

“Ngjyrimi stilistik është vetia e mjeteve të përfshira në organizimin dytësor, që të bien në sy, të ngjallin një përshtypje ose shoqërimin me një ndjenjë, situatë, fushë veprimtarie etj. Një veti e tillë në semantikë quhet konotacion, është vlera kuptimore plotësuese që lind nga lidhja me një kod tjetër. Ngjyrimet janë konotacione stilistike, kundrejt të cilave qëndrojnë denotacionet ose vlerat shenjuese të mjeteve gjuhësore, tërësi e tipareve dalluese ose e semave”²⁷.

p.sh. “*E ka ni d’rrasë mongi*” dhe “*nuk shkeli n’drrasë tij*”, fjalë dërrasë ka kuptime plotësuese, pra këtu kemi të bëjmë me konotacion, ndryshe nga rastet kur japim mesazh të qartë: është budalla dhe nuk i besoj.

²⁷ Xhevat Lloshi, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1988, f.31.

Kreu III

Kuptimi si anë e fjalës

3.1. Fusha kuptimore e fjalës (Shembuj)

Fusha kuptimore e fjalës shënon pasuri shpirtërore, kuptimet dytësore që u vishen fjalëve i veçojnë krahinat, moshat, gjinitë etj. Fjalët me kuptim negativ, ironizues, mosbesues e përbuzës kanë përdorim shumë më të shpesht se ato me ngjyrim pozitiv dhe madje janë më të shumta në numër, kjo me gjasë se pikërisht kuptimet jo të drejtpërdrejta na mundësojnë t'i shprehim më lirshëm mendimet e ndjenjat tona, pa u prekur aq personi që i drejtohem, pasi disi e zbusin situatën dhe shpesh krijojnë përshtypjen e një shakaje, por që realisht bazohet fort në realitetin.

Fjalët në kuptimin e plotë të fjalës me ngjyrim pozitiv të mbështetura nga ana emocionale përdoren për ta ngritur edhe më lart figurën e një personi të dashur, sikur synojmë ta largojmë nga mangësitë dhe joperfeksioni i shoqërisë njerëzore.

Këto përdorime kërkojnë përqëndrim të vëmendjes, konteksti gjuhësor dhe jashtëgjuhësor e shtyjnë dëgjuesin ose lexuesin për të parë marrëdhëniet e fjalëve. Janë fjalët me shumë kuptime që dëshmojnë rëndësinë dhe funksionimin e lidhjes së fjalëve, duket si diçka jashtëzakonisht e komplikuar që një fjalë gjatë bashkimit me të tjerat ta ndryshojë krejtësisht kuptimin e saj, kështu lidhet pandashëm gjuha me psikologjinë. E njëjta fjalë madje, e pa lidhur me të tjerat, e shoqëruar nga intonacioni jo i zakonshëm i zërit, apo nga gjestet e njeriut, i jep kuptime të ndryshme të njëjtës fjalë, ndonjëherë të pakapshëm për dëgjuesin si kuptime të dyta, larg nga domethënia e kuptimit të parë. P.sh fjala *rrush* në lidhje me të tjerat: *I boni paret rrush e kumlla* (i shpenzoi të gjitha, por nuk bëri diçka që duhet, i hargjoi kot); *Shkoi si qeni n'rrush* (shkoi kot); *rrushi e she rrushin e nis me u pjek* (e shohin njeri-tjetrin e marrin vetitë e njëri-tjetrit).

Ujë-uji: u dridhke si thupra n'ujë (frikësohej shumë) ; *ujë e paske bo* (e ka mësuar mirë, kjo zakonisht e ka kuptimin ironizues) *kunglli mi ujë nuk shkon tanaheret* (nuk shkojnë punët gjithmonë mirë, ashtu si dëshiron).

Rëndë : “Zonjë e randë: zonjë e matun në çdo pikëpamje”²⁸; *fol fjalë t’rona* (flet fjalë fyese); *boll ron po e kom atë njeri* (s’mund ta duroj).

Dorë (gjymtyrë) : *E ka dorën e keqe* (vjedh) ; e *gjun gurin e e mshef dorën* (tinzar) ; *Ja ngjiti dorën* (i ndihmoj); *i lamë durt* (e pat puna jonë); “Ne i lamë duert: i hoqëm shpresat”²⁹. ; *I kisha durt e shlira* (mund të veproja si të doja).

N’qafë teme le: (unë e marr përgjegjësinë); *Hiqmu qafe!* (Largohu!) *Mos e mer n’qafë!* (mos e dëmto, mos ia prish punët!)

Folja nxej: *u nxeva* (u nervozova) ; *nxeje karrikën!* (ulu e mëso); dhe tani si mbiemër *s’jom i nxehtë n’k’to punë* (s’jam entuziast).

Pe (pe, peri) : *Mos l’sho pe!* (mos u dorëzo, mos i lë hapësirë); *I kallxova fill e për pe* (i tregova hollësisht).

Do të japim disa shembuj të fjalëve që kanë kuptime të dyta me ngjyrim negativ, të tilla si: *bukël, plesht, lorzë, macë (mace), therrë, gacë e mlutë, paqyrë para dilli, strincë, sorrë, gjarpen, serrnishtë, bimbash, qyqe, breshkë, grabujë, uri, turrecë, dosë, hurun, minak, menja e prishtë (tog.), çakallë e mullinit (emër +emër), pulë e lagtë (tog.)...* (ndodh që të përdoret vetëm çakallë, me kuptimin e njëjtë edhe pulë përdoret e veçuar në raste të caktuara).

Në anën tjetër janë fjalët me kuptim emocional pozitiv: luan, bardhe, dukat, lirë, gur, gojëfil, rrush, shpatë, dritë, drugzë etj. .

P.sh. fjala bukël (u referohet femrave që veprojnë fshehurazi, mundohen të mbajnë sekrete, janë tinzare me një fjalë); për gjininë mashkullore me këtë kuptim (tinzak-tinzar) përdoret fjala uri (e *majke kryt teposht si uri*);

plesht (në kuptimin i vogël); ~ *lorzë*: kur qesh me zë të lartë; ~ *macë* : e imët; *gacë e mlutë*: paraqitet ndryshe e është ndryshe (person që s’mund t’i besosh, pasi vetëm bëhet si i urtë); ~ *paqyrë para dilli* (person dyfytyrësh, ndryshon varësisht nga situata); ~ *serrnishtë* (pa mend fare: *S’ka men n’kry, o serrnishtë*); ~ *qyqe* (*Ish krejt qyqe*: e pazonja, s’mund t’i kryejë punët ose nga frika i lë të pa përfunduara) ; ~ *grabujë* (vetëm synon të marr nga të tjerët, po jo të jap); ~ ~ *çakallë e mullinit* (flet shumë: *Folke e s’i jepke ren kuj, ish si çakallë e mullinit*) ;

²⁸ Mehmet Gjevori, *Frazeologji shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1968, f.194.

²⁹ Po aty, f. 47.

“HURUN~I m.sh.~Ë,~ËT (S) koprrac, dorështrënguar; huruni që është ai- dorështrënguari që është ai; njeri i mbyllur, tekanjoz (M.E)”³⁰ .

MINAK,~U m.sh. ~Ë,~ËT (vth) 1. Qen i vogël; njeri shtatvogël”³¹ . ;~ fjala gjarpën (me këtë trajtë tek të vjetrit kurse gjerpën te më të rinjët) ka kuptimin i rrezikshëm, kjo ka ndërtuar edhe kuptimin e figurshëm në shkallën sipërore: gjarpën me dy krena; gjarpën me shtatë krena (shumë, shumë e rrezikshme: *Ajo ish gjarpën me shtatë krena; Aaa gjarpnësia si ish..*)

.....
Luan (trim); ~ dukat (me të gjitha të mirat);~ shpatë (punëtore, e zonja) ; ~gjeraqinë (e madhe, e zonja, e shpejtë); ~ çelik (i fortë);~ drugzë (e shkathët); lirë (e vogël, por e vlefshme, me këtë fjalë zakonisht u drejtohen vajzave, që përkundër gjatësisë shquhen për veti të mira). Llastik (*ish si llastik*): shumë e shkathët, e aftë ta bëjë çdo lëvizje; breshkë (e ngadalshme).

GOJËFIL,~I m (Dr.) bot. lloj bari fije-hollë i familjes së skrofulariceve me ngjyrë të bardhë. Del më shumë nëpër dëllinja...”³² me këtë fjalë me ngjyrim përkëdhelës u drejtohen vajzave të vogla.

Në kuptimin e ndajfoljes mirë (Si je? Mirë, faleminderit!) përdoren edhe: Si vera; si e pesemdheta honë (pesëmbëdhjeta hënë) dhe varg (të gjithë mirë), kurse për të vegjlit: si drita.

Disa fjalëve u përcaktohet funksioni nga lidhja me fjalët e tjera dhe nga situatë gjuhësore, p.sh. *Je n'fun t'pusit* (Je në fund të pusit) : si ke punët aspak mirë, je shumë keq dhe në anën tjetër : *M'u dhimt pusi* : në këtë rast shprehet ndjenja e dhembshurisë për vdekjen dhe nuk bëhet fjalë për një person të ligë (pus).

Me kuptim të ngatërruar paraqiten fjalët: pupëz, skripçë (sa të veshura me ngjyrim ironizues, aq edhe me ngjyrim pozitiv, duke ju referuar zogjve të vegjël, por të shkathët e të menqur, cilësit e të cilëve kalojnë te vajzat).

Me kuptim negativ përdoren dhe dimjan e gogisht. Dimjan në kuptim kot ose huq në lojën kapuças, por në ligjërimin e zakonshëm e ka kuptimin e një pune që s’kryhet mirë dhe gogisht, poashtu në kuptimin keqas.

³⁰ Grup autorësh (Instituti Albanologjik i Prishtinës), *Fjalor fjalësh e shprehjesh popullore*, Prishtinë, 1982, f.138.

³¹Po aty, f. 201.

³²Po aty, f. 113.

Kreu IV

Njësitë frazeologjike

4.1. Njësitë frazeologjike

Më herët kemi thënë se fjalët zakonisht nuk përdoren të veçuara, por të lidhura me njëra-tjetrën, kjo lidhje kushtëzohet nga realiteti dhe kërkesat e logjikës. Lidhja e fjalëve varet nga kuptimet leksiko-gramatikore të tyre, pra nuk mund të flasim për lidhje të pakufijshme.

Ne mund të formojmë togje të zakonshme (kur vërehet shoqërim i vazhdueshëm mes sendeve a dukurive) dhe togje të qëndrueshme (kur lidhjet bëhen të përhershme). “Së fundi, togjet e qëndrueshme, kur pësojnë ndryshime kuptimi si tërësi dhe përdoren si njësi të gatshme leksikore, kthehen në togje frazeologjike”³³.

Termi frazeologji vjen nga gjuha greke: phrasis, ka kuptimin: shprehje, njësi e ligjëritimit; dhe logos: dije ose dituri. Njësitë frazeologjike kanë kuptim të mëvetësishëm, fjalët e bashkuara kanë ndërtim të qëndrueshëm dhe pas një kohe përfundojnë si njësi të pandashme.

Përgjithësimi i tyre në përdorim i kthen një pjesë në frazeologji thjeshtë gjuhësore, por fjalët mbi të gjitha kanë valencën shprehëse. “Togfjalëshat me veçoritë e tyre, shërbejnë si një burim shprehësie. Përftesat me frazeologjinë janë një lloj përpunimi i saj, i cili i rigjallëron, i bën të ndjeshme veçoritë e ndërtimit e të semantikës së tyre, që janë ngurosur po ashtu siç fshihet forma e brendshme e fjalës pas ndërtimit të saj”³⁴.

Frazeologjia është sidomos karakteristike për ligjërimin bisedor.

Nëpërmjet përftesave formohen stilemat, të cilat kur bëhen të zakonshme kthehen në klishe ose stereotipa. “Kur thuhet: frazeologji letrare, frazeologji publicistike, zyrtare, politike, nënkuptohen plotësisht stilemat e kthyerat në klishe. Të tilla janë edhe fjalët e urta e shprehjet e tjera folklorike, e sidomos shprehjet standarde të gjuhës bisedore (urimet, mallkimet, betimet)”³⁵.

P.sh. “*Bija asht si bryma para diellit*”³⁶.

“*I ra t’ mirës shkelm*”³⁷.

³³ Xhevat Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, Toena, Tiranë, 1999, f. 124.

³⁴ Po aty, f.124.

³⁵ Po aty, f. 124.

³⁶ Halil Kajtazi, *Fjalë të urta nga Drenica*, ULPI, Prishtinë, 2005, f. 28.

³⁷ Po aty, f. 69.

Ai që të gjun me gurë, ti gjuje me bukë. E çon me njo e s'munesh me hungj me dhetë. Nuk ngihet sa breshka dhe. Harrni për thes. I hup 100 pite për ni laknur. I ngiti t'unit s'ja ka besë. Ka t'fryn fryma, ktheje gzofin. Kur t'djeg tomli, i fryn edhe kosit. Ku dhem dhomi, shkon guha. Kur t'thojnë ka dredhza shumë, mere krojshen e vogël. Kur thehet kerri, udhë ka sa t'dush. Me ni hu nuk thuret gardhi. Shtrej komt sa e ki jarganin. Uki kimen e ndrron, po zanatin s'e harron. Kali i huj t'len n'rrugë. Pika-pika bohet bistrica. Gjaki ujë s'bohet.

“-Aj qi shkon i pari n'arë, s'i thotë kuj: Puna e marë!”³⁸

“Aj e ka ni kâmë n'dhe, e ni kamë mi dhe”³⁹.

Urimet, mallkimet e betimet: *Koft me jetë t'gat'! U rritë me prind! U boft plak me mjekërr! U boft prej ti ni katun! T'i përkunt djemt! ... T'biftë bari n'shpinë! Mos pafsh ditë me sy! Mos t'daltë kun nafakë! Daç e mos mujsh! T'raftë pika! ...Pasha Zotin; Pasha get ditë..* Njësitë e tilla quhen frazeologji letrare, nuk janë frazeologji gjuhësore, sepse nuk kanë strukturë togfjalëshi, sepse kanë vlerë fjalie, kurse njësitë frazeologjike gjuhësore kanë strukturë fjale.

Faktet stilistike veprojnë në trajtë e kuptim, frazeologjitë kështu kanë humbur diçka nga zanafilla e stilemës. “Frazeologjia në kuptimin leksikologjik nuk mund të veçohet me rreptësi shkencore pa njohur nocionin e stilemës. Në thelb, çdo frazeologji lind si një stilemë dhe me kohë fiton mëvetësinë ose një pavarësi relative nga konteksti”⁴⁰. Motivimi frazeologjik fillon nga gjetja e përftesës fillestare.

Te njësia frazeologjike lidhjet sintaksore nuk janë aq të qarta sa te togjet e lira, pasi lidhjet objektore janë zbehur. Realisht, njësitë frazeologjike e kanë burimin te togjalëshat e lirë, pasi për një kohë të gjatë këta togfjalëshat shkëputen nga kuptimi i parë dhe e kristalizojnë kuptimin e figurshëm. Veçohen edhe të ashtuquajturat formime analogjike, p.sh. nga *mbledh njerëzit*, është formuar njësia frazeologjike *mbledh mend*.

Njësitë frazeologjike dallohen nga togjet e lira të fjalëve pikë së pari, sepse nuk krijohen spontanisht gjatë bisedës, por bëhen pjesë e ligjërit si njësi të gatshme, ato nuk mund të zërthehen, pasi kryjnë funksionin e një gjymtyre të vetme (*Mos hin n'thes me to* dhe *mos u bëj si ai*; në rastin e parë e kemi shumë më lehtë, pasi e kemi njësinë e gatshme). Numri dhe rendi i gjymtyrëve të njësive frazeologjike nuk ndryshon (rendi i gjymtyrëve është i ngulitur, prishja e tij e shkatërron njësinë f.). Ashtu si te fjalia e perbërë ose e përngjitur lidhja e gjymtyrëve nuk

³⁸ Destan Bajraktari, *Fjalë të urta dhe thënie popullore shqipe*, Eurographic, Prishtinë, 1944, f. 23

³⁹ Po aty, f.10

⁴⁰ Xhevat Lloshi, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1988, f. 103

duket, pasi togu frazeologjik shënon një koncept, gjymtyrët e kanë humbur pavarësinë kuptimore. Nuk ka mundësi që nga mënyra e formimit të një njësie frazeologjike të formohen njësi të tjera (nuk krijohen gjedhe) dhe as nuk mund të bëhet përkthimi i një njësie fjalë për fjalë.

4.2. Klasifikimi i njësive frazeologjike

Njësitë frazeologjike mund t'i klasifikojmë sipas ndërtimit, shkallës së motivimit dhe vlerave leksiko-gramatikore.

Sa i përket ndërtimit, njësitë frazeologjike ndahen në njësi me strukturë togfjalëshi dhe me strukturë fjalie. Ndërtimi i togfjalëshit mund të jetë: emër+emër (*brez pas brezi; me mish e me shpirt, si maca me miun...*); emër+ mbiemër (për *faqe të bardhë; për faqe të zezë; me zemër të hapur*); folje+emër (*m'u bë zemra mal; i doli boja; e bën mizën buall*); folje+emër+mbiemër (*e nxori në udhë të madhe, nuk shkel në dërrasë të kalbur*); etj. .

Njësitë frazeologjike me strukturë fjalie janë më të pakta, fillojnë zakonisht me fjalë shërbyese. Këto njësi kanë lindur nga ngurosja e fjalive të plota (fjalët nuk mund të përdoren në të gjitha format e tyre të mundshme, p.sh. emri përdoret vetëm në një trajtë).

Njësitë frazeologjike mund t'i ndajmë edhe në bazë të shkallës së motivimit, disa motivohen edhe sot e disa duan shpjegime historike dhe etimologjike. Një ndihmësë të madhe motivimit i ofron gjetja e gjymtyrës drejtuese. Kështu mund të kemi vatër që përcakton vlerën leksiko-gramatikore (*ngriti krye*: vlera përcaktohet nga gjymtyra foljore), vatër kuptimore (bëj durim: kuptimin e përcakton gjymtyra e dytë, por te disa njësi frazeologjike vatër kuptimore është togfjalëshi në tërësi: *shkel e shko*), vatër ideomatike (peshë në këto raste mbahet nga gjymtyra e pamotivueshme: *re të vë re*), vatër stilistike-emocionuese (*dhelpër plakë*, gjymtyra e parë e mbart peshën e kuptimit stilistiko-emocional), vatër fjalëformuese (fjala mund të ketë kuptim të njëjtë me njësinë frazeologjike: *ia dha në dorë < dorëzoi*).

Në gjuhën shqipe janë shumë të veçanata njësitë frazeologjike të pamotivuara (quhen ndryshe edhe përngjitje frazeologjike ose idioma), kuptimi është krejtësisht i paqartë dhe mund të zbulohet vetëm me gjurmime historike dhe etimologjike. Ndërtimet e tilla në përbërje kanë një arkaizëm, mund të kenë dalë nga një anekdotë, ndodhi a ngjarje historike (*i lau durt*) dhe që nuk kanë togfjalësha të lirë gjegjës (*shet mend*, përdoret vetëm si njësi frazeologjike).

Njësitë frazeologjike të motivueshme janë më të shumta dhe ndahen në grupe. “*Grupin më të pasur e përbëjnë njësitë frazeologjike që kanë dalë nga shndërrimi i figurshëm i togfjalëshave të lirë; në to dallohet lidhja ndërmjet kuptimit të njësisë frazeologjike dhe kuptimit të togfjalëshit të lirë prej nga buron ajo”⁴¹. Te njësitë e tilla nuk mund të flasim për ngurosje të plotë, gjymtyrëve mund t’u ndryshohet vendi, të zëvendësohen me sinonime dhe t’u futet ndonjë fjalë në mes. Edhe më të motivueshme e bëjnë një njësi frazeologjike gjymtyrët e figurshme dhe njëra prej tyre me kuptim të drejtpërdrejtë (*bëj be*).

“Njësitë frazeologjike klasifikohen edhe duke i përqasur me pjesët e ligjëratës, kryesisht me emrat, me mbiemrat, me foljet e me ndajfoljet. Mirëpo vlera e tyre leksiko-gramatikore varet shpesh nga përdorimi në fjali, nga lidhjet që kanë me fjalë të tjera”⁴². Në bazë të kësaj njësitë frazeologjike ndahen në njësi frazeologjike emërore, mbiemrore, foljore e ndajfoljore.

Njësitë frazeologjike me gjymtyrë emërore: *burri i botës, petulla me ujë, të zitë e ullirit*.

Njësitë frazeologjike mbiemërore kanë vlerë mbiemërore dhe funksionojnë në gjuhë si mbiemra: *bukë e djathë, gazi i botës (dy gjymtyrë emërore)*; njësitë e tilla frazeologjike mund të përbëhen nga një emër dhe një mbiemër: *teneqe e shpuar* (që s’mban të fshehta), *daulle e shpuar* (llafazan), dia fillojnë me lidhëza: *si kali pa fre* (i shfrenuar), disa nisin me parafjalë: *me një dërrasë mangët* (i marrë), *me kryet përperjetë* (mendjemadh), *me një këmb në varr* (i plakur). Shumë pak ka njësi të përbëra nga dy folje: *fol e qesh, shkel e shko*.

Njësitë frazeologjike foljore: *i mori shpirtin, i jap dorën, i bëj sytë katër, ia futi këmbët në një këpucë, i hedh hi syve...* njësitë ndajfoljore me vlerë ndajfoljore: *brez pas brezi, hap pas hapi, vend e pa vend, shkel e shko* etj. .

Pasurinë kryesore të frazeologjisë e përbëjnë njësitë me burim popullor, të cilat shfaqin veçoritë kombëtare të gjuhës, historinë dhe zhvillimin e saj, shfaqin etno-kulturën dhe psikologjinë popullore.

Njësitë frazeologjike veçohen edhe në bazë të aftësisë për të shënuar sende, dukuri, cilësi a veprime ashtu si fjalët dhe aftësisë për t’i vlerësuar, sidomos duke u mbështetur në kuptimin emocional. Te njësitë frazeologjike vërehet animi për përshtatje me normën stilistikore kundrejt normës gjuhësore.

⁴¹ Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Toena, Tiranë, 2006, f. 224.

⁴² Po aty, f.227.

“Shtresën e parë, më të gjerë e më kryesore, e përbëjnë njësitë frazeologjike që kanë qenë e janë pronë e mbarë gjuhës, për të cilat as historikisht nuk mund të vërtetohet burimi krahinor, kurse në gjendjen e sotme nuk ka asnjë tregues krahinor: brez pas brezi, me krahë të hapur, marr vesh, me mend në kokë, shkel e shko, s’e prish gjakun, vë re...”⁴³.

Shtresa e dytë përbëhet nga njësitë frazeologjike me burim dialektor a krahinor, por që janë pronësuar nga gjuha standarde : *gjallë e ngushtë, sheh përtej bjeshke...*dhe në shtresën e tretë përfshihen njësitë dialektore e krahinore, njësitë e tilla janë të lidhura ngushtë me dukuritë e një krahine.

Krahas njësive frazeologjike të përvetësuar nga gjuha standarde, pritet edhe shumë të tjera të ndjekin këtë rrugë, sepse i favorizojnë vlerat shenjuese dhe aftësia për laramani shprehëse. Shumë njësi frazeologjike mund të përgjithësohen për vlerat e ndryshme që kanë, pasi për to ka sinonime, duke u zbuluar gradualisht vlerat plotësuese të frazeologjisë shqipe.

Frazeologjizmat krahinor mund t’i nënshtrohen përpunimit fonetik, përpunimi u bëhet gjymtyrëve veç e veç. Edhe përpunimi gramatikor është i mundshëm, por duhet pasur kujdes në ruajtjen e dukurive krahinore. Njësitë frazeologjike mund të përgjithësohen me një përpunim të plotë leksikor (fjalët jashtë norme zëvendësohen me fjalë të përgjithshme, disa njësi mund të përgjithësohen duke ruajtur fjalët krahinore në përbërje dhe në rastin e fundit janë disa njësi që kanë përdorim shumë të kufizuar dhe nuk përgjithësohen, ato mbetën të përdoruara brenda një të folmeje për qëllime stilistike.

⁴³ Jani Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Toena, Tiranë, 2006, f.240.

4.3. Shembuj dhe shpjegime

Jom bo akull (ngrina prej të ftohtit); *e bon punën angari* (e bën punën shkel e shko); *na u ke bo si biberi* (na humbe); *m'ranë komt* (u lodha duke ecur); *m'ka ra shpija n'kry* (më ka rënë barra për mbajtjen e familjes); *ta ka nxon rrota bishtin* (ke rënë ngushtë); *u bo bozë ajo punë* (u bë punë e mërzitshme); *çan d'rrasa* (fol kot); *i kcen damari shpejt* (nervozohet shpejt); *ni here vjen vera ka dera* (një herë të bie në dorë një gjë e mirë); *jonë si dita me natë* (janë krejt të ndryshme); *kom pre gozhda* (jam ngi nga të ftohtit); *mos bluj shumë!* (mos fol shumë!); *rrishin si n'thera* (nuk rrinin rehat); *mos i bjer kuj n'guj!* (mos iu perkul askujt); *e kom n'maje t'gues* (e di, por s'më kujtohet); *osht' honë-honë* (me teke); *mos u muno mem qit hi syve!* (mos u përpjek të më mashtrosh!); *nuk osht' fort i hollë* (nuk është i menqur sa duhet); *pa honger hudër, nuk t'vjen era* (pa shkak nuk flitet për ty); *hyp se t'vrava, zhdryp se t'vrava* (as andej, as këndeje, kur s'di si të veprosh); *ka le me k'mishë* (ka lind me fat); *ja shtini dy komt ni k'pucë* (e ngushtoi); *ma k'puti shpirtin* (më preku shumë, ndjeva dhimbje për të), *ai po lypke konop t'lagt* (po kërkoi me u rrah mirë); *i dul krah* (e përkrahu); *e don si krypen n'sy* (nuk e don fare); *e ke bo punën lomsh* (e ke ngatërruar punën); *bini mas!* (kujdesuni për të!); *nuk ma mushi synin* (nuk mu duk i zoti); *mos e bon mizën bullë!* (mos e zmadho punën!); *i nguli komt* (ngulmoi); *e ki xhepin e nxehtë* (ke para); *e gjeti Ora e ligë* (e gjeti rreziku); *doket si n'ploomë t'dorës* (duket shumë qartë); *u bone prrallë* (u bëre gazi i botës); *nuk pin ujë kjo punë* (nuk shkon kjo punë); *bjen me pula* (flen herët); *ta non shkelmin n'bark* (është mizor); *e tjerr fort* (e stërhollonë); *mos hin n'thes me to!* (mos u bëj si ai!);

Disa prej këtyre njësive frazeologjike përdoren në formë dëftimi (*jom bo akull; m'ranë komt; bjen me pula*), disa në formë lutjeje (*bini mas!*), disa në formë urdhëri (*mos em nxej!*) etj. .

Përfundimi

Përdorimi i fjalëve me kuptim emocional dhe i njësive frazeologjike tregon një lidhje të ngushtë mes gjuhës dhe trurit. Gjuha në njërin anë sistem i thjeshtë, por që ndikimi shoqëror i ka dhënë një rrugë tjetër.

Përdorimi i një fjale me kuptim të thellë e krejt të ndryshëm nga kuptimi themelor e shndërron gjuhën në shkencë e art njëkohësisht, deshifrimi i tyre në njërin anë zgjidhje formule, por përzgjedhja e tyre në anën tjetër mjeshtëri, apo aftësi, që lindet ose mësohet.

Shenja gjuhësore tani ka një të shënjuar jo të zakonshëm, me kontraste kuptimore, sado që shenjuesi mbetet po ai i njëjti edhe pse për kuptimet në fjalë ekzistojnë shenjues të ndryshëm, që kanë përdorim të zakonshëm, por pse bëhet ky ndërrim i vendeve, kjo mbetet anë e errët e psikikës njerëzore, që reflektohen me anë të gjuhës, “pasqyrës së trurit”.

Kuptimet figurative paraqiten si vlerë e veçantë e fjalës, që ndër të tjerat e rrisin vëmendjen e bashkëbiseduesit dhe e bëjnë shumë më interesant komunikimin, pasi i shpëpusin lidhjet me vijat e drejta, ku një formë është e barabartë me një përmbajtje. Kuptimet figurative e zgjerojnë horizontin e fjalës, e paraqesin pasurinë shpirtërore të një populli.

Konotacioni shpreh kulturën shpirtërore të popullit tonë, p.sh. fjala gur :*insoni ma i fort se guri*(tani kjo njësi frazeologjike flet edhe për historinë, fjala insan vjen nga turqishtja, mjafton kjo për të shpjeguar sundimin dhe ndikimin osman; *bone zemrën gur; e gjun gurin e mshef dorën* (ky ndërtim i përgjigjet fjalës tinzar, por për arsye të caktuara, folësi e përzgjedh këtë ndërtim, në vend të një fjale shumë më të thjeshtë) duke shprehur kulturën shpirtërore të trashëguar. Njësitë frazeologjike janë shumë të njëjta në zona të ndryshme, ato dallohen kryesisht nga aspekti fonetik.

Vetëm krijimi i fjalëve nuk e pasuron gjuhën, një kuptim i ri është një vlerë e re, që flet po aq sa një fjalë.

Literatura

- Bajraktari, Destan, *Fjalë të urta dhe thënie popullore shqipe*, Eurographic, Prishtinë, 1994.
- De Saussure, Ferdinand, *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*, Dituria, Tiranë, 2002.
- Gjevori, Mehmet, *Frazeologji shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1968.
- Gjinari, Jorgji dhe Shkurtaç, Gjovalin, *Dialektologjia*, Perlat Voshtina, Tiranë, 2003.
- Grup autorësh (Instituti Albanologjik i Prishtinës), *Fjalor fjalësh e shprehjesh popullore*, Prishtinë, 1982.
- Grup autorësh(Universiteti Shtetëror i Tiranës), *Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve të gjuhës shqipe*, Mihail Duri, Tiranë, 1972.
- Kajtazi, Halil, *Fjalë të urta nga Drenica*, ULPI, Prishtinë, 2015.
- Lloshi, Xhevat, *Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1988.
- Lloshi, Xhevat, *Stilistika dhe pragmatika*, Toena, Tiranë, 1999.
- Martine, Andrea, *Elemente të gjuhësisë së përgjithshme*, Rilindja, Prishtinë, 1974.
- Memushaj, Rami, *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, Tiranë, 2004.
- Thomai, Jani, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Toena, Tiranë, 2006.